

DHOMA E NOTEREVE

Nr. 1978/Rep

Nr. 208/Kol



AKT TRANSFERIMI PRONESIE
MBI KUOTAT E KAPITALIT SHOQEROR

Sot me 20 qershor 1996, para meje Noterit *Sanjta keshu*, u paraqiten:

- Z. Antonios Samaras, shtetas grek, me numer pasaporte *3.795058* dhe

- Z. Christoforos Chatzopoulos, shtetas grek me numer pasaporte K 594764 te cilet deklaruan qe:

- Me date 2 dhjetor 1994, Z. Antonios Samaras, shtetas grek, Z. Teodor Misha dhe Z. Artan Meci te dy shtetas shqiptare, nenshkruan para Noterit

Haris aktin e krijimit te shoqerise ADRION sh.p.k, me seli ne Tirane ne rrugen Sami Frasheri, Pall.11, Shk 3, Ap.26, me kapital shoqeror ne vleren Leke 1.200.000(njemilionedyqinmije)-, prej te cilit Z. Antonios Samaras zoteron 51% te kuotave, Z. Teodor Misha zoteron 29% te kuotave dhe Z. Artan Meci 20% te kuotave.

- Shoqeria ADRION sh.p.k eshte regjistruar ne Regjistrin tregtar Shqiptar me date 5.12.1994 me vendimin Nr. 7467 te gjykates se rrethit Tirane.

- Ortaku Antonios Samaras, me vullnetin e tij te lire e te plote dhe pas aprovimit me unanimitet nga Asambleja e Ortakeve, vendosi ti shese

Z. Christoforos Chatzopoulos nje pjese te kuotave te tij (60,1%) e barabarte kjo me 31 % te kuotave te kapitalit shoqeror, kundrejt nje cmimi te njejte me vleren nominale te kuotave, Leke 372.000.

- Z. Christoforos Chatzopoulos, me vullnetin e tij te lire e te plote, vendosi te bleje kuotat e siperpermendura kundrejt cmimit 372.000 leke duke u bere keshtu ortak I shoqerise ADRION sh.p.k me 31 % te kuotave te kapitalit shoqeror.

Ne vazhdim, Z. Christoforos Chatzopoulos I paguan teresine e shumes prej Leke 372.000, Z. Antonios Samaras.